



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 768/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada Glllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur lidhur me apelin e Hisen Berisha, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilin ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datë: 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.768/2021 i datës 05.03.2021, i paraqitur nga Hisen Berisha, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datë: 14.02.2021, me të cilin ka kërkuar rinumërim të votave në të gjithë këto vendvotime: Komuna e Gjakovës: 0201c/01R, 0201C/2R, 0201c/03R, 0201C/04R, 0201C/05D, 0201C/06R, 0201C/07D, Komuna e Rahovecit në këto vendvotime:1624-01R, 1624-02R, 1624-03D,1626-01R, 1626-02R, 1626-03R, 1626-04R, 1626-05R, 1626-06R,1626-07R, 1626-08D, Komuna e Dragashit në këto vendvotime:0501A-01R,0501A-02D,0501X-02D,0502A-01R,0502A-02D,0503A-01R,0503A-02R,0503A-03E,0503A-04R,0503A-05R, 0503A-06D,0506A-02R,0503A-03D, 0507A-01R, 0507A-02R,0507A-03R, 0507A-04D, Komuna e Pejës në këto vendvotime:1701c/01R, 1701c/02R,1701c/03R,1701c/04R, 1701c/05R, 1701c/06D, 1704x/01R; 02R, 03R, 04R,05R, 06R, 07R, 08R dhe 09R/D, 1705c/01R,2R, 03R,04R, 05R, 06D, 1705X/01R, 02R, 03R, 04D, 1723/03R, 02D, 03R, 04R, 05R, 06R, 07R, 08D, 1703c/01R, 1703c/02R, 1703c/03R, 1703c/04D.

A r s y e t i m

Me datë 05.03.2021, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) Hisen Berisha ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.768/2021, me të cilën pretendon se totali i votave të tij të shpallura nga KQZ është 9161 vota. Kandidati konsideron se janë lëshuar gabime në QNR, nga përcjellja permanente e rezultatit në QNR deri para përmbylljes së këtij procesi. Kandidati pretendon se ka qenë fitues i ulëses në parlament, mirëpo procesi i rinumërimit ka ndikuar në rritjen e votës në shumicën e kutive të rinumëruara. Parashtruesi i apelit thekson se është dëmtuar në rezultat nga mos evidentimi i saktë i votës nga ana e KVV-ve në shumë vendvotime në komuna të ndryshme. Votën të cilën e kërkon është vota e familjes së gjerë, vota e përkrahësve dhe simpatizantëve të tij.

Parashtruesi i apelit kërkon rinumërim në këto vendvotime të ndara sipas komunave: Komuna e Gjakovës: 0201c/01R, 0201C/2R, 0201c/03R, 0201C/04R, 0201C/05D, 0201C/06R, 0201C/07D, Komuna e Rahovecit në këto vendvotime: 1624-01R, 1624-02R, 1624-03D, 1626-01R, 1626-02R, 1626-03R, 1626-04R, 1626-05R, 1626-06R, 1626-07R, 1626-08D, Komuna e Dragashit në këto vendvotime: 0501A-01R, 0501A-02D, 0501X-02D, 0502A-01R, 0502A-02D, 0503A-01R, 0503A-02R, 0503A-03E, 0503A-04R, 0503A-05R, 0503A-06D, 0506A-02R, 0503A-03D, 0507A-01R, 0507A-02R, 0507A-03R, 0507A-04D, Komuna e Pejës në këto vendvotime: 1701c/01R, 1701c/02R, 1701c/03R, 1701c/04R, 1701c/05R, 1701c/06D, 1704x/01R; 02R, 03R, 04R, 05R, 06R, 07R, 08R dhe 09R/D, 1705c/01R, 2R, 03R, 04R, 05R, 06D, 1705X/01R, 02R, 03R, 04D, 1723/03R, 02D, 03R, 04R, 05R, 06R, 07R, 08D, 1703c/01R, 1703c/02R, 1703c/03R, 1703c/04D. Në këto komuna parashtruesi i apelit thekson se ka votë të anëtarësisë së partisë dhe përkrahësve të tij të cilat vota pretendon që nuk janë evidentuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm pretendime sepse pritjet e ankuesit për të marrë sa më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka edhe mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja e bere nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Hisen Berisha i subjektit politik PDK, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave me kusht dhe atyre me postë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.768/2021 më datën 06.03.2021

Kryesuesja e Panelit
Kymete Kicaj

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.

